

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT  
INSTITUTI I NDËRTIMIT**

**Procedura për përzgjedhjen e bashkëpunëtoreve të jashtëm**

**NJOFTIM**

**Kërkesë për shprehje interesi**

**Instituti i Ndërtimit**, është Institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit i cili funksionon në bazë të Ligjit nr. 7582 “Për ndërmarrjet shtetërore” me ndryshime Bazuar në VKM nr. 1055 datë 22.12.2010 “Për Vendosijen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe Urdhërimit nr. 197 të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, si dhe në Urdhërin e Ministres së MZHUT nr. 197 datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrveshjes për kryerjen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe në Rregulloren e Brendshme “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtoreve të jashtëm për kryerjen e opionencave teknike për projektet e ndërtimit të objekteve me vlerë të preventivuar jo më pak se 100 milion leke”.

**NJOFTON**

1. Të gjithë personat e interesuar mund të shprehin interesin e tyre për lidhjen e kontratave të bashkëpunimit për opionentë të jashtëm për kryerjen e opionencave teknike për projektin Konstruktiv, Projektin Arkitektonik, Projektin e Vlerësimit Mjedisor, Projektin e Infrastruktues Rrugore, Projektin Elektrik, Projektin Hidroenergjitik, Projektin Hidroteknik, Projektin e instalimeve Hidrosanitare. Bashkëpunëtorët e jashtëm duhet të plotësojnë këto kërkesa:

1.1 Kërkesa të përgjithshme:

- a) përvoja në fushën inxhinierike
- b) licenca
- c) Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- d) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- e) Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- f) Të përdorin kompjuterin, në programet SAP dhe ETABS

1.2 Kërkesa të veçanta :

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në Deget: Ndërtim, Konstruksion, Arkitekture, Hidroteknik, Elektrik, Mekanike, Infrastruktura Rrugore, Mjedis.
- b) Të kenë përvojë aktive në profilet respektive mbi 15 vjet
- c) Të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillim të tyre profesional.

2. Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për Aplikim;
- b) CV;

c) Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë, e noterizuar;

d) License te noterizuar

(Per Konstruktoret kerkohet: Kategoria "Projektim per objekte mbi 8 kate", ose "Projektim objekte me veshtiresi te shkalles se larte").

2. Dokumentacionet e mesiperme duhet te sillen prane Institutit te Ndertimit

3.Me Urdhër te Titullarit te institucionit krijohet Komisioni per perzgjedhjen e bashkepunetoreve te jashtem i cili ka për detyre te verifikoje plotësimin e kriterëve te aplikanteve. Komisioni eshte i përbërë nga 5 specialiste te fushave te ndryshme te Inxhinierisë. Ky komision mban dokumentacionin administrativ te procedurës

4.**Lista përfundimtare** e bashkepunetoreve te jashtem kalohet për miratim ne Këshill Drejtues dhe përzgjedhja e kandidateve për objekte te veçanta behet sipas nevojës se Institucionit, ku Drejtori ne bashkëpunim me Departamentin e oponencave dhe zyrën juridike përpilon kontratat përkatëse.

(dokumentat e mesiperme duhet te jene te noterizuara)

Shprehjet e interesit duhet te dorezohen ne adresen e meposhtme .:

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Instituti i Ndertimit, Departamenti i Oponencave dhe Rregullave Teknike.

Versioni i plotë i Njoftimit për Kontratat e bashkepunimit është në dispozicion në:

[www.institutindertimit.al](http://www.institutindertimit.al) DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

**INSTITUTI I NDËRTIMIT**

**DEPARTAMENTI I RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE**

Rr:“Muhamet Gjollesha” Tirane, Shqipëri